



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së njëmbëdhjetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 10.12.2018, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Migjen Shala (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Florida Canolli (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA), Bukurie Canolli (LB) dhe Baton Dushi (Nisma).

Munguan: Visare Gashi (PSD), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Valbona Petrovci, e pavarur, Vlora Dumoshi (LDK), Fiknete Bejta (AAK), Uran Ismaili (PDK), Sokol Berisha (AAK) dhe Yll Bogaj (AAK).

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Agim Kuleta, kryesuesi i Kuvendit. Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Osman Bllaca propozoi që si pikë e rendit të ditës të jetë edhe "Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2019".

Faqe 1 nga 18

Egzon Azemi kërkoi që pyetjet të cilat parashtrihen nga anëtarët e Kuvendit të shkruhen në mënyrë korrekte, por e njëjtë le të veprohet edhe me përgjigjet e drejtorëve.

Kërkojmë që pika e katërt dhe e pestë: "Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit" dhe "Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A1, të lagjes "Dodona", përderisa nuk bëhet Harta zonale, mos të procedohen më tutje, d.m.th. të hiqen nga rendi i ditës.

Eman Rrahmani theksoi se pika e katërt dhe e pestë e rendit të ditës janë futur në rend të ditës pa miratimin e KPF-së, pra aty nuk e kanë marrë shumicën e votave dhe nuk kanë kaluar.

Agim Gashi u shpreh se lidhur me fillimin e ndryshimeve të planeve rregulluese, gjithmonë arsytimi është dhënë bazuar në Udhëzimin administrativ 01/18.

Në këtë udhëzim administrativ në asnjë nen nuk parashihet që të fillojë procedura e ndryshimeve të planeve rregulluese, pastaj këto të inkorporohen në rastin e hartimit të Hartës zonale. Ekzekutivi duhet pasur parasysh këtë situatë dhe duhet vënë një bazë ligjore, e vetmja thënie bazë ligjore është nxjerrja e Hartës zonale, përshpejtimi i procedurave dhe sjellja e dokumentit në Kuvend për miratim. Por, mos të thirren në këtë, por le të thirren vetëm në interpretim të gabueshëm të Ministrisë e jo në dokument.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e z. Bllaca.

Kryesuesi konstatoi se një zëri u miratua propozimi që në ren dite të futet pika "Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2019".

Lidhur me fillimin e ndryshimeve të planeve rregulluese, **Fatos Dibra**, përfaqësuesi i Zyrës ligjore, tha se neni 11, paragrafi 2 i Ligjit për planifikimin hapësinorë, thotë: "Autoriteti përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor, siguron që Plani zhvillimor komunal dhe Harta zonale e Komunës përfshinë të gjitha planet rregulluese urbane dhe planet rregulluese të hollësishme mund të miratohen paraprakisht, por ato inkorporohen në Hartën zonale.

Halim Halimi theksoi se edhe në mandatin e kaluar të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me planet rregulluese që i kemi miratuar, të gjitha vendimet janë kthyer të kundërligjshme nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ne kemi të drejtë t'i nxjerrim, por duhet ta respektojmë ligjin. Nenet 16 dhe 17 të Ligjit për planifikimin hapësinor, e kanë përcaktuar shumë qartë se për t'i miratuar ne planet e hollësishme është Harta zonale.

Shefki Gashi tha se këto propozimvendime para se të sillen në Kuvend, të sqarohen mirë, andaj dhe sjelljet e njerëzve përgjegjës për punë të caktuara po më bëjnë me dilema të shumta, me dilema të tepërta për punë formale, për gjëra shumë të vogla të mos i maltretojmë qytetarët. Ju kisha lutur që të mos krijojmë përçarje, por të punojmë në dobi të qytetarëve.

Vala Peshku u shpreh se për neve është e rëndësishme me u diskutuar këto materiale dhe me u përpjekur për t'iu bërë zgjidhje qytetarëve, andaj ky kundërshtim që po bëhet

prej LDK- së dhe LVV- së, është një shou medial që janë duke e bërë, pra për gjithçka janë, vetëm për qytetar nuk janë!

Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, tha se çështja e Planit rregullues "Dodona" është e kamotshme, në vitin 2016 ka kaluar ky plan. Ky plan nuk është iniciuar, sepse në shpjegimin e Ministrisë thuhet se nuk mundet Plani i hollësishëm detaj me e tejkualuar PZHU-në, koeficientet edhe atë çka e jap PZHU-ja si plan më i lartë. Për këtë arsye nuk kemi mundur me e iniciuar sipas PZHU- së, në këtë hapësirë infrastruktura ka qenë në shpërputhje me Planin rregullues, koeficientet kanë qenë shumë të vogla dhe qytetarët nuk janë pajtuar dhe nuk kemi pasur hapësirë me e realizuar.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e z. Azemi.

Kryesuesi konstatoi se më 19 vota për, 17 kundër dhe 4 abstenime, hiqen nga rendi i ditës pika e katërt dhe e pestë: "Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit"" dhe "Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A1, të lagjes "Dodona"".

Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për dhe 2 kundër, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të vazhdimit të mbledhjes së nëntë dhe ekstraktit të mbledhjes së dhjetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ali (Latif) Bekës;
3. Propozimvendimi për tatimin në pronën e paluajtshme;
4. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë;
5. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve financiare NPL "Sport Marketing";
6. Propozimvendimi për miratimin e Strategjisë së zhvillimit të turizmit në komunën e Prishtinës;
7. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Busi;
8. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2019;
9. Pyetje dhe përgjigje;
10. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të vazhimit të mbledhjes së nëntë dhe ekstraktit të mbledhjes së dhjetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Eman Rrahmani bëri vërejtje në ekstrakt, duke thënë se është mirë që Shërbimi i Kuvendit në ekstrakt me e paraqitur atë të cilën e flasim, e kjo ka të bëjë me mbledhjen e kaluar, ku ka qenë si temë e diskutimit edhe Plani i hollësishëm rregullues për Prishtinën e Re. Në emër të LVV-së kam paraqitur kërkesë, që të mos vijë asnjë plan i hollësishëm rregullues deri në përfundimin e hartimit zonal dhe Planit zhvillimor.

Migjen Shala vërejtje bëri kryesisht për kryesuesin, rreth udhëheqjes së mbledhjes, i cili tha se dikujt i jep fjalën e dikujt jo, nganjëherë po e lejon dike me folur e pastaj tjetrin nuk po e lejon. Ai kërkoi nga kryesuesi që të jetë më korrekt në kryesimin e seancës.

Vala Peshku tha se është mirë që hartuesi i ekstraktit të procesverbalit të ketë një kujdes pak më të shtuar rreth hartimit të tij.

Rifat Deri u shpreh se sot e kërkova fjalën jashtë rendit të ditës dhe nuk mu dha fjala, por ka raste kur dikujt tjetër i jepet fjala jashtë rendit të ditës e mua jo. Unë desha ta paraqes një kërkesë të qytetarëve të Prishtinës, por kjo nuk mu lejua.

Kryesuesi tha se nuk ka nevojë për një sqarim jashtë rendit të ditës dhe këtë çështje mund ta shtroni në pikën "Të ndryshme".

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për, 4 kundër dhe 1 abstenim, u miratuan ekstrakti i procesverbalit të vazhimit të mbledhjes së nëntë dhe ekstrakti i mbledhjes së dhjetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ali (Latif) Bekës.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Agim Gashi kërkoi sqarim rreth këmbimit të parcelës, duke thënë se pjesa që merret për këmbim është për tre arë sipërfaqe më e vogël se pjesa që jepet.

Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, tha se këtë propozimin për këmbim e kemi sjellë në saje të ujdisë gjyqësore që është arritur në Gjykatë lidhur me këtë kontest gjyqësor, ndërsa vlera financiare e pronës do të përcaktohet nga Ministria e Financave.

Eman Rrahmani tha se edhe më herët kam kërkuar që pas vlerësimit të vendimit që bëhet nga Ministria e Financave, të na prezantohet këtu në Kuvend, të na sillet nga një dokument se çfarë vlerësimesh janë bërë për ato prona të cilat i kemi këmbyer. Drejtoria e Pronës asnjëherë nuk i ka sjellë vlerësimet të cilat i ka bërë Ministria e Financave.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për dhe 4 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ali (Latif) Bekës.

Pika e tretë

Propozimvendimi për tatimin në pronën e paluajtshme.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Mirsad Vitia tha se rruga "Ulza" e cila është në zonën numër pesë, e që ndodhet në Hajvali, dhe rruga "Dëshmorët e Gollakut", e cila është në qendër të Hajvalisë, është në zonën e gjashtë, dhe vlerësimi i një prone nuk është njësoj si te Fshati Ndërkombëtar që është në rrugën "Ulza", si në Hajvali. D.m.th. nëse kishte mundur me u ndarë kjo rrugë me një kryqëzim të caktuar, që do t'i takonte zonës numër pesë edhe pjesa tjetër zonës numër gjashtë.

Ai kërkoi sqarim nga Drejtoria e Pronës se a është e mundur me u bërë ndarja e kësaj rruge.

Agim Gashi tha se ajo çka është me interes për të gjithë këshilltarët këtu sa i përket kësaj rregulloreje, është që të dimë më shumë rreth formulës së llogaritjes së tatimit në pronë. Është fjala në tatimin në tokë, sepse ne sot po diskutojmë për bashkëngjitje të risisë, bazuar në Ligjin përkatës, rreth pronës që deri më tash nuk është tatuar, pra është fjala për pronën bujqësore, malet, kullosat edhe llojet e atyre pronave që po i bashkëngjiten tash si risi kësaj rregulloreje. Ne kërkojmë të dimë se cila është baza mbi të cilën Ministria do ta vlerësojë bazën e vlerës së tokës, malit, kullosës dhe pastaj mbi të cilën Komuna do ta caktojë shkallën e tatimit.

Migjen Shala kërkoi përgjigje nga ekzekutivi se kush është i liruar nga tatimi, cilat kategori janë të liruara me ligj prej kësaj takse. Në nenin 7 të kësaj rregulloreje, shihet se janë të liruara kategoritë e dala nga lufta, mirëpo kjo nuk është duke u respektuar nga Komuna e Prishtinës, kurse në komuna tjera respektohet, përveç lokaleve afariste. Pra, te vlerat e luftës Komuna e Prishtinës nuk e respekton këtë rregullore. Pse nuk e respekton, kush është ai person, kur ai ligj është miratuar në Parlament?! Nuk mundet një Komision me verifikuar për diçka që është vendosur sipas ligjit, nëse i ka kushtet e vështira. Unë jam invalid i luftës, personalisht, shembull, edhe tash ti me më vlerësuar mua, kur mua ma mundëson ligji. Nëse i kam kushtet e vështira, jo, ai është beneficion me ligj që i takon. Beneficionin nuk mundeni me vlerësuar si komision as ti, as kryetari i Komunës.

Arbenita Murseli tha se sa i përket këtij vendimi të tatimit për pronën e paluajtshme, kjo temë duhet të trajtohet me kujdes, duke i siguruar avantazhe bizneseve të vogla dhe të mesme. Pse mos të ulet tarifa e tatimit për këto lloje biznesesh, kur dihet se qëllimi i tyre është që përmes fitimit të gjenerojnë edhe vende të reja të punës, duke siguruar kështu që produktet e tyre të jenë edhe më të fuqizuara në treg. Nga tarifa e tatimit 0.17% e tatimit sa e kanë tash, të ulet në 0.10%, e t'u japim mundësi bizneseve të zhvillohen.

Shefki Gashi tha se paraprakisht, ne është dashur me pasur edhe një tekst përcjellës për kategorizimin e tokave bujqësore të të gjitha llojeve, çoftë ato kullosa, çoftë livadhe apo toka pjellore. Ne është dashur me pasur një elaborat, të punuar prej ekspertëve të Ministrisë, se si do të procedohet për të marrë një vendim, sepse këtu po thuhet që me datë 31.10.2018, Ministria e Financave ka marrë atë vendim, por na autorizon edhe neve që me marrë një vendim me miratuar në Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

Andaj, ne nuk dimë se çka po miratojmë, nëse dikush e di, le të na e shpjegon sa është apo në cilën kategori do të jetë po e zëmë vlera e tokës pjellore, në cilën kategori do të jetë vreshta, në cilën kategori do të jenë serat, në cilën kategori do të jenë stallat e fermerëve. Kështu që nuk e ke asnjë kategori të caktuar se ku është dhe sa vlerësohet. Po ashtu, do të ishte mirë që të definohen kategoritë e personave të cilët janë të liruar nga ky tatim.

Adrian Berisha tha se sa i përket heqjes së pikës 7.3, që u potencua nga parafolësi, kishte qenë mirë me i ditur se kush janë këta të dalë nga lufta edhe e kishim hequr edhe atë pikë. Ndërsa sa i përket asaj se Komuna nuk ka bërë asgjë për këto kategori të caktuara, në komunë ka parkingje, të cilat shfrytëzohen padrejtësisht nga organizatat e dala nga lufta, të cilat qesin barriera në lagje të ndryshme të qytetit.

Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, tha se kjo rregullore është hartuar në vitin 2016, por puna e këtij Komisioni që është paraparë në nenin 7.3, është menduar me u bërë një lloj komisioni që ato dokumente që e parasheh Ligji, duhet të shqyrtohen nga një komision. Këto janë kategori ligjore dhe përfitimin e atyre nuk mundet me e ndalu as me rregullore.

Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se çdo komision që formohet, pavarësisht prej kujt, kryetari i formon komisionet që i nënshkruan, komisionet shkojnë prej drejtorisë, secili komision duhet bazuar në ligje, nuk mundet të dalë komisioni jashtë ligjeve dhe detyrë e këtij komisioni është që të bënë kontrollimin e dokumenteve. Problemi se çka e përcakton te veteranët, ose te kategoritë e dala nga lufta, ose në Ligjin e tatimit në pronë, ky komision për bazë e merr Ligjin e tatimit në pronë, brenda ligjit të tatimit në pronë lirohet vetëm në rast se i ka kushtet e vështira, nuk e përjashton veteranin apo kategoritë tjera të dala nga lufta, por e specifikon se duhet me i pasur kushtet e rënda ekonomike.

Egzon Azemi tha se ligji në fakt është shumë pozitiv, dhe më në fund po vjen një ligj kaq i mirë, që tek e fundit i stimulon bujqit dhe pronarët e tokave bujqësore që ta punojnë tokën, në fakt thelbi i ligjit është ky. Një shqetësim që e kam, është se a është menduar ndonjë strategji se si do të informohen pronarët e tokave bujqësore në lidhje me këto ndryshime të ligjit.

Leonora Shabani-Bajraktari tha se po t'i referohem nenit 7.2 të kësaj rregulloreje, thuhet se nga tatimi në pronën e paluajtshme lirohet edhe kategoria e personave të verbër, andaj nga lirimi nuk janë paraparë kategoritë e tjera me aftësi të kufizuara. Atëherë, a duhet të bëjmë edhe këtu ndryshime sa i përket lirimit të tatimit në pronë, për arsye se Komuna nuk ofron shërbime që ua lehtëson sado pak jetën këtyre personave?

Leutrim Retkoceri tha se sa i përket nenit 7, që është lirimi nga tatimi në pronë të paluajtshme për kategoritë e veçanta, që në këtë rast janë familjet e dëshmorëve, familjet e të zhdukurve të UÇK-së, të invalidëve të luftës dhe veteranët e luftës, por këtu pak është një kundërshtim me atë që e ceku edhe zyrtari ligjor. Nuk është propozimndryshim, as propozimplotësim, por është propozimvendim, i cili është i plotë.

Pra, t'i heqim gjërat që janë kontradiktore edhe që na bëjnë burokratizim se nuk janë të nevojshme. Pajtohem me propozimin e z. Shala, që neni 7.2 të hiqet.

Qëndrimi i grupit tonë parlamentarë është që të hiqet neni 7.3 dhe pika 7.3, pikë e cila parasheh personat me gjendje të rëndë ekonomike, pra ose të lirohen, ose mos të lirohen, dy çështje janë këtu.

Drilon Pireva shprehu mendimin se paraprakisht është dashur një interpretim prej Ministrisë, Ligji për tatimin në pronë dhe Ligji për statusin e të drejtave të dëshmorëve dhe veteranëve të luftës. Do të thotë, ishte dashur fillimisht kjo të sqarohet, se edhe unë për vete kam shumë hall, se pse këto kategori sot paguajnë tatim në pronë, edhe nuk ishte dashur me vazhduar më me këtë logjikë.

Ideja është që në rast se interpretimi i Qeverisë thotë që duhet me zbatuar Ligjin për tatimin në pronë para këtij ligji tjetër, atëherë ne duhet me iniciuar në Kuvend të Kosovës ndryshimin e ligjit dhe derisa nuk bëhet kjo, këto pjesët tjera janë të parëndësishme. Sa i përket komisionit, tha se ai është komisioni i brendshëm komunal, i cili thjesht ka me bërë pranim të dokumentit, pra ka për detyrë me e bërë kompletimin e dokumentacionit. Kërkojmë nga Drejtoria e Financave që me kërkuar një interpretim sa më të shpejtë prej Qeverisë, me na shpjeguar se cili ligj duhet të zbatohet, ose në rast se kjo nuk bëhet, ne duhet gjithsesi përmes subjekteve tona me iniciuar që këtë ligj me e ndërruar në Kuvendin e Kosovës.

Eman Rrahmani e përkrahu plotësisht propozimin që pika 7.3 të largohet nga rregullorja, gjithashtu edhe Drejtorisë së Financave i kisha kërkuar që rrugën "Fahri Fazliu", e cila nuk gjendet në asnjë zonë, të caktohet në zonën e pestë, faktikisht është në zonën e katërt. Në Rregullore e vitit 2016, ekziston rruga "Fahri Fazliu", kurse tani në Rregulloren e vitit 2017 nuk ekziston.

Agim Gashi bëri vërejtje për ekzekutivin, i cili tha se është për keqardhje që nuk e keni një person kompetent që i jap sqarimet për të gjitha pyetjet që i shtrojnë këshilltarët, d.m.th nuk e keni përpara një person kompetent që e njih mirë këtë fushë dhe dinë të përgjigjet në pyetjet që i shtrojnë këshilltarët. Po të ishte një zyrtar i tillë nuk do të kishte vend për dilema. Komunën e Prishtinës ka zyrtarë që dinë dhe e njohin këtë fushë, dinë me dhënë sqarime, kështu që herëve të tjera të mos përsëriten këto mangësi, se kjo po e dëshmon që ju jeni të papërgatitur e jo ne.

Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, tha se sa i përket pyetjeve të cilat u parashtruan rreth zonave tatimore, Komuna i përcakton vetëm normat tatimore edhe i cakton zonat. Këto zona në këtë rregullore nuk janë dhe këto zona janë në Rregulloren e vitit 2016. Kurse sa i përket të dhënave të cilat edhe ne i kemi kërkuar nga Ministria e Financave, Departamentit të Tatimit në Pronë, si do të furnizohemi ne apo si do ta dimë se cilat zona, sipas tyre jemi urdhëruar që të gjitha shënimet për të gjitha llojet e tokave, të merren prej shënimeve kadastrale. Sipas Ligjit për tatimin në pronë, parashihet që Kuvendi i Komunës, apo çdo komunë të caktojë normën tatimore për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike.

Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, tha se në Rregulloren e vitit 2016 ishte propozuar që të formohet një komision, i caktuar nga kryetari, për ta shqyrtuar dokumentacionin në përputhje me udhëzimet që na i ka dhënë Ministria, prandaj këtë çështje e shpjegoi edhe përfaqësuesi i Zyrës ligjore, që ndryshimi i rregullores kërkon procedura, kërkon diskutim publik, nuk mundet me u bërë tani me këtë vendim ndryshimi i Rregullores së tatimit në pronë.

Nol Nushi tha se pika të cilën po e diskutojmë praktikisht ka ardhur për shkak të përditësimit të kësaj rregulloreje me ndryshime ligjore në nivel qendror. Ka ndryshuar një ligj atje dhe ne duhet me qenë brenda afatit me ndryshuar rregulloren, me ia përshtatur atij ligji, që prej 2019 me filluar zbatimin i sanksioneve apo detyrimet që dalin prej atij ligji. Nuk shoh këtu që ka ndonjë vullnet kundër me e hequr komisionin, por është ideja që qysh me e bërë atë ndryshim të qëndrueshëm.

Halim Halimi tha se ne jemi për aprovimin e kësaj rregulloreje, të këtij vendimi, kështu si është ne do të votojmë, por nëse heqim diçka nga rregullorja, atëherë duhet të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i rregullores. Kështu që me pritje plotësimin dhe ndryshimin e rregullores, ne vonohemi për Ministrinë e Financave, ka ardhur situata ashtu si ka ardhur, grupi ynë e voton, d.m.th. është për këtë vendim, me kusht që le të fillojë në vitin e ardhshëm plotësimi dhe ndryshimi.

Vala Peshku bëri thirrje që të votohet ashtu si është ky propozimvendim, me kushtin që menjëherë në vitin e ardhshëm ne kemi me filluar me diskutime publike rreth përpilimit të rregullores apo përmirësimit të saj.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin ashtu si është i propozuar.

Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për tatimin në pronën e paluajtshme.

Pika e katërt

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, 32 vota për, u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë.

Pika e pestë

Propozimvendimi për lejimin e mjeteve financiare NPL "Sport Marketing".

Kryesuesi hapi diskutimin.

Adelina Fazliji, në cilësinë e anëtares së Komisionit komunal të aksionarëve të NPL "Sport Marketing" tha se menaxhmenti i ri i ndërmarrjes ka trashëguar një gjendje jo të mirë financiare dhe një organizim të dobët brenda dhe me probleme të tjera menaxheriale.

Aktualisht, kjo ndërmarrje menaxhon vetëm me dy operatorë, Pishinën e Gërmisë, e cila funksionon vetëm muajve të verës dhe Shtëpinë e Gurit, e cila aktualisht është në kontest pronësor me Komunën e Shtërpcës. Bazuar në këtë gjë që e thash, ndërmarrja ka funksionim sezonal. Në rrethana të tilla na mbetet neve si Kuvend t'i dalim në ndihmë ndërmarrjes në shlyerjen e borxheve dhe obligimeve të krijuara vite më parë, pasi që Komuna është 100% aksionare në këtë ndërmarrje.

Sami Boroci tha se ne si grup parlamentar e përkrahim këtë kërkesë, mirëpo me këta dy operatorë, Shtëpia e Gurit dhe Pishina e Gërmisë, të cilat janë veç sezonale, mendoj se ka me qenë shumë e vështirë me funksionuar më tutje kjo ndërmarrje. Një zgjidhje më e mirë për këtë ndërmarrje do të ishte që salla "1 Tetori" dhe hapësirat reklamuese në Prishtinë, t'i jepen në menaxhim kësaj ndërmarrje, dhe besoj se nuk kishte pasur nevojë për subvencionime në forma të tilla.

Arbenita Murseli theksoi se kjo ndërmarrje e zhytur në shumë borxhe ndaj shumë palëve, që nuk iu siguron dot paga as punonjësve të saj, e që bartja e mjeteve nga ana e Komunës për ndërmarrjen në fjalë do të ishte e mirëseardhur, duke pasur parasysh edhe gjendjen e rëndë në të cilën është ndërmarrja. Gjithashtu, edhe shtëpizat në Parkun Gërmia, që për momentin po i shfrytëzon NP "Hortikultura", duhet t'i kthehen ndërmarrjes "Sport Marketing", në mënyrë që t'i sigurojë edhe të ardhurat që po i nevojiten.

Adrian Berisha u shpreh se parimisht jemi për me e subvencionuar ndërmarrjen "Sport Marketing", por kishte me qenë mirë me na sjellë dokumentacion shtesë se si ka ardhur deri tek kjo gjendje e mjerueshme, e cila është keqpërdorur jashtëzakonisht shumë, e jo të na sillt një plan biznesi i cili lë shumë për të dëshiruar. Kisha sugjeruar me angazhuar një kompani, në mundësi, për me bërë një plan biznesi se si duhet edhe njëherë e mirë me shpëtuar këtë ndërmarrje nga falimentimi.

Shefki Gashi tha se kjo është një padrejtësi e madhe, që me paratë e tatimpaguesve ne me i subvencionuar ndërmarrjet fiktive, të cilat nuk kanë kurrfarë menaxhimi, nuk kanë kurrfarë afarizmi, nuk kanë kurrfarë aftësie për me ekzistuar, kështu që më mirë do të ishte që ata 15 punëtorë sa janë në këtë ndërmarrje, t'i marrë Komuna dhe t'i sistemojë në rrogë, varësisht prej obligimit që kanë. Nuk e di se me çfarë të drejte ne mundemi me i subvencionuar, me iu dhënë rroga njerëzve të cilët nuk janë punëtorë administrativë ose punëtorë të rregullt të Komunës. Është ndërmarrje e cila nuk i ka shfrytëzuar resurset që i ka. Kjo ndërmarrje i ka zyrat në qendër të qytetit, nga ato zyra mund t'i përfitojë 15 mijë euro qira, e ai kuadër mund të bartet në Gërmia, në zyra te Pishina, dhe me i siguruar rrogat prej këtyre qirave që mund t'i kenë. Pra, mund të thuhet se kemi të bëjmë me një ndërmarrje, e cila në menaxhimin e punëve të saja është shumë pasive.

Halim Halimi theksoi se ne duhet ta analizojmë se pse ka ardhur në gjendje të tillë ndërmarrja "Sport Marketing", a mos jemi ne fajtor si Komuna. Për një mandat të tërë nuk është punuar dhe nuk janë lejuar Komisionet e aksionarëve dhe bordet e drejtorëve të bëjnë punë në ndërmarrje publike, kështu që unë mendoj se faji është i yni, i Komunës, se nuk i ka lejuar të punojnë. Një prej burimeve shumë të mira ka qenë edhe Shtëpia e Gurit në Brezovicë, e cila i është lënë stihisë, dhe për këtë Komuna e Shtërpcës ka marrë vendim për mbylljen e saj, sepse është shkatërruar dhe kërkon rinovim. Kjo qeverisje e Komunës për një mandat të tërë, nuk e ka parë të rrugës me e rinovuar atë objekt dhe me i dërguar nxënësit në Shkollën e skijimit në Brezovicë. Ne do ta votojmë, do t'ju mundësojmë edhe njëherë, por të mos krijohet shprehi që vit për vit me i subvencionuar këto ndërmarrje.

Agim Gashi tha se puna e ndërmarrjes varet nga kushtet atmosferike, verës diell, kurse dimrit borë. Kjo ndërmarrje nuk është zhvilluar më shumë, ka pasur mundësi të aftësohet

Qendra e fëmijëve në Gërmi, të krijohet biznesi i tretë, objektet janë të gatshme, por është përdorur për diçka tjetër.

Kjo ndërmarrje nuk mund të rimëkëmbët pa një infuzion nga Komuna. Nuk ka pasur qarkullim katër vjet, nuk ka funksionuar Bordi si duhet, as nuk ka pasur bashkëpunim në mes ekzekutivit dhe ndërmarrjes. Duhet me ia dhënë një infuzion me u stabilizuar. Duhet pasur bashkëpunimi në mes Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Financave dhe drejtorive të tjera. Ne duhet ta përkrahim, por nuk mundemi pa e thënë se fajtor për ardhjen në këtë gjendje ka qenë qeveria komunale, sepse e ka politizuar situatën dhe ai politizim na ka kushtuar me shkatërrimin e ndërmarrjes.

Besnik Mujeci tha se këtu ku është paraqitur planprogrami i punës për vitin 2019, nuk janë paraqitur saktësisht detajet dhe nuk e dimë se cilat aktivitete janë paraparë. Po ashtu, për fillimin e këtyre aktiviteteve nuk ka mjete financiare, nëse po, atëherë kush ka me i financuar këto përpos Komunës.

Këtu thuhet se veprimtarinë do ta bazojmë në shfrytëzimin e objekteve ekzistuese të kulturës fizike me të cilat ajo disponon, por ku janë të listuara fushat ekzistuese sportive të cilat ata planifikojnë që t'i mirëmbajnë, përpos Pishinës së Gërmisë.

Ai në vazhdim pyeti se a kanë për qëllim të ndërtojnë ndonjë objekt të ri, apo vetëm i kanë shënuar këto, dhe lidhur me Shtëpinë e Gurit në Brezovicë, pyeti se që sa vite ekziston ajo pronë kontestuese dhe pse nuk është ndërmarrë asnjë hap që Komuna e Prishtinës ta kthejë atë pronë në pronësi të saj, pasi që i është uzurpua padrejtësisht nga Komuna e Shtërpcës.

Egzon Azemi shprehu mendimin se nuk është interes i këtij pushteti me i rivitalizuar ndërmarrjet e tilla që nuk kanë fitimprurje dhe nuk kanë lidhje me biznese. I vetmi synim i këtij ekzekutivi ka qenë Ndërmarrja Publike Banësore, ndërmarrja "Termokos" dhe ndërmarrje të tilla ku në pyetje janë milionat. Ndërmarrjet si këto që janë në shërbim të qytetarëve lihen kështu në harresë.

Ky Plan i biznesit që na ka ardhur këtu, nuk është diçka që na premtonte rivitalizimin e kësaj ndërmarrje, por vetëm na premtonte në njëfarë forme se do të mbijetojë kjo ndërmarrje.

Do të duhej ta dinin edhe ndërmarrja, edhe Komuna çka po ndodh sot me Shtëpinë e Gurit në Brezovicë. Normalisht që Komuna e Shtërpcës të paditë dhe thotë se ajo është pronë e imja, kur shihet se Komuna e Prishtinës nuk e ka asnjë interesim për atë objekt, prandaj duhet të tregohemi më serioz dhe duhet me qenë më konkret e jo vetëm me vazhduar e me i mirëmbajtur këto.

Nol Nushi tha se për me u funksionalizuar si duhet kjo ndërmarrje, duhet me qenë pak në nivel të detyrës, se ndryshe nuk mundet me u zgjidhur problemi i asaj ndërmarrje. Kjo ndërmarrje i ka vetëm dy asete, Pishina e Gërmisë dhe Shtëpia e Gurit, e papërdorshme për shkak të kontesteve gjyqësore edhe politike atje në Shtërpcë. Kjo ndërmarrje është shkatërruar nga Komuna dhe pikërisht para këtyre dy mandateve, ku ndërmarrjet publike kanë pasur plan të qartë se si shkatërrohen, si iu hiqen asetet e tyre, si shpartallohen deri në pikën kur nuk ke mundësi as me i mbajtur ata punëtorë.

Vesel Makolli theksoi se për të ekzistuar kjo ndërmarrje, duhet të ndihmohet, sepse është për të mirën tonë, por duhet ta bëjmë një prerje dhe t'i shikojmë gjërat realisht e mos t'i shikojmë nga këndet tona, por të flasim për një interes të përgjithshëm.

Shkaku që ka ardhur deri tek kjo gjendje, është se shumë veprimtari në njëfarë forme, iu kanë marrë apo nuk i janë lejuar që kjo me i kryer, pastaj koha apo klima që ka ekzistuar sivjet është një lëshim, andaj është dashur me bërë një analizë edhe me caktuar çka ka penguar në këtë rast. Mendoj se të ardhurat kanë qenë shumë minimale sivjet nga Pishina e Gërmisë. Prandaj, duke u bazuar në të gjitha këto, ne duhet ta ndihmojmë, urgjent ta mbulojmë me këtë kërkesë këtë ndërmarrje, por duhet të kërkojmë që në të ardhmen, pasi është menaxhmenti i ri, ta bëjë një plan të mirëfilltë biznesi edhe të shikojmë si mundet kjo ndërmarrje me dal nga kjo krizë.

Eman Rrahmani u shpreh se ky vendim që jemi duke e marrë, jemi duke e marr për një periudhë të kaluar, që është për pagat e ish-Bordit të vitit 2012, 2013, nuk është vetëm për qeverisje të kaluar, por është edhe për më shumë se qeverisja e kaluar e qeverisjes së 4-5 viteve të kaluara. Edhe te parashikimet që janë bërë, në bazë të këtij plani parashihen të ardhurat nga Shtëpia e Gurit, ku dihet që ajo shtëpi nuk është duke u menaxhuar prej ndërmarrjes "Sport Marketing", nuk kanë të drejtë as qasje me shkuar në atë shtëpi.

Mendoj se është një lloj manipulimi i këtij Plani të biznesit, që në njëfarë mënyre na tregon shkurt që nuk do të ketë asnjë sukses në vitin e ardhshëm, duke iu referuar këtij plani që është sjellë këtu. Mendoj se kjo nuk është përgjegjësi e jona por e Bordit, të cilët do të duheshin të jepnin llogari për dështimin e kësaj ndërmarrje. Këto nuk janë ndërmarrjet e ekzekutivit, e as nuk duhet me i dhënë llogari ekzekutivit, këto duhet me i dhënë llogari Kuvendit komunal dhe aksionarëve. Kuvendi komunal edhe secili që jemi aksionarë, jemi përgjegjës edhe për gjendjen e këtyre ndërmarrjeve. Ne sot këtu duhet të votojmë për shkak se njerëzit kanë mbetur pa rroga tash e sa kohë, mirëpo definitivisht nuk jemi duke bërë zgjidhje. Edhe në bazë të këtij plani kemi me qenë në situatë të njëjtë!

Fadil Gashi u shpreh se një menaxher i ndërmarrjes e cila nuk funksionon si duhet, i ndihmoi apo nuk i ndihmoi Komuna, prapë ka me shkuar në falimentim. Ne edhe kësaj radhe do t'i ndihmojmë, mirëpo nëse nuk është menaxhimi i mirë kjo prapë do të shkojë në humbje.

Mirsad Vitia tha se për mua kishte me qenë me interes të veçantë sikur të ishte e ditur se kush dhe pse e ka sjellë ndërmarrjen në këtë gjendje. Duke e ditur se si menaxhohen këto ndërmarrje, konsideroj se bordet kanë qenë të detyruara për me e mbrojtur këtë ndërmarrje, gjë që i bënë përgjegjës direkt, ose aksionarët.

Këto borxhe janë nga ish-bordet nga viti 2012 dhe në total borxhi për bordet dhe ish-bordet për vitet 2013, 2014, 2015, ka qenë në shumën prej 33.705 €. Propozoj që t'i votojmë mjetet që ndahen për këtë ndërmarrje, mirëpo me kushtin që bordeve mos t'iu ndahen pagat, shkaku që ato borde kanë qenë direkt përgjegjëse për me e mbrojtur këtë ndërmarrje mos me lënë me ardhur në këtë gjendje.

Shefqet Osmani theksoi se në tabela janë paraqitur obligimet për paga ndaj punëtorëve, bordeve, ku vlera e tyre është 130.415 €, mirëpo në faqen e fundit të këtij materiali, kjo ndërmarrje kërkon edhe dhjetë mijë euro shtesë jashtë kësaj vlere, për renovim të Shtëpisë së Gurit, për furnizim me dyshekë, batanije, jastëk etj.

Ai pyeti se a do të votojmë shtesë plus dhjetë mijë euro për ndërhyrje në Shtëpi të Gurit, apo vetëm për obligimet të cilat i ka ndërmarrja deri tash.

Kryesuesi bëri të ditur se votimi bëhet vetëm për shumën e mjeteve prej 130 mijë euro.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për lejimin e mjeteve financiare NPL "Sport Marketing".

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për miratimin e Strategjisë së zhvillimit të turizmit në Komunën e Prishtinës.

Kryesuesi e hapi diskutimin.

Osman Bllaca, në emër të ekzekutivit tha se Strategjia është katërvjeçare, 2019-2022, dhe për zbatimin e saj e kemi edhe linjën buxhetore që e kemi miratuar.

Në kuadër të Drejtorisë së Kulturës është paraparë edhe Sektori i turizmit, dhe me planin e punës së Burimeve njerëzore, është paraparë të jenë shefi i sektorit dhe dy zyrtarë të tjerë për promovim të turizmit. Ky është një hap i ri që po bëhet drejtë turizmit në komunën e Prishtinës.

Adrian Berisha shprehu mendimin se kjo Strategji është nga dokumentacionet më të mira të Komunës që e kam pasur deri më tash, por kam një shqetësim, që jepet te faqja 60, ku te atraksionet dhe infrastruktura askund nuk përmendet zona e Gollakut, e që unë si asamblist mendoj se zona e Gollakut kishte qenë njëri ndër resurset në të cilat, nëse kishim investuar si Komunë, kishim mundur me bërë një zonë malore atraktive, e cila kishte me qenë e vizituar prej turistëve që vijnë në komunën e Prishtinës. Po ashtu, nuk kam parë diçka konkrete për shtigjet e ecjes dhe biçikletave në parkun "Gërmia". Shpresoj që ky dokument nuk do të mbetet vetëm në letër, por do të punohet seriozisht në të, për arsye se, sipas statistikave, turizmi, është njëri ndër indikatorët kryesorë të hyrjes së të hollave në shumë qytete të botës.

Agim Gashi theksoi se Strategjia sjell informacione mjaft reale dhe interesante, sepse është një fushë e cila shumë pak është prekur deri më sot. Mendoj se gjatë hulumtimit nuk janë identifikuar të gjithë indikatorët e nevojshëm që mundën ta bëjnë edhe më komplet dokumentin. Pajtohem me mendimin e kolegut që tha për turizmin rural, përkatësisht Gollakun.

Prishtina ka pasur edhe më herët njëfarë plani, për t'u marrë pak a shumë me turizmin rural, gjë që ka mbetur pastaj në gjysmë, është harruar dhe nuk është zhvilluar sa duhet, me përjashtim të një projekti që është realizuar në zonën e liqenit të Badocit, përkatësisht në zonën kadastrale të Novosellës ose të Mramorit, që është Kopshti i arinjve, i cili aktualisht ka më së shumti vizitorë, ku sipas informacionit të fundit diku deri më 30 qershor, 30 mijë vizitorë i ka pasur Kopshti i arinjve, deri në fund të vitit kanë mbërrir ndoshta 100 mijë, dhe objekti që ka aq shumë vizitorë nuk përfshihet në Strategji! Pastaj, siç e dimë, nga zona e arinjve deri te Gërmia është i planifikuar shtegu i këmbësorëve, për të cilin Komuna do të ndajë mjete dhe do ta ndërtojë. Po ashtu, shtegu

për motoçiklistë, çiklistë, shëtitore të ndryshme etj., që është atraksion. Atraksioni tjetër është sportet malore dhe pika për monitorimin e sporteve malore është maja e Zllashit. Pastaj janë objektet kulturo – historike, siç është Kalaja e Novobërdës, Ulpiana, qyteti i lashtë, Kalaja e Harilaqit edhe ndoshta ndonjë objekt tjetër që alternativisht lidhet me turizmin në komunën e Prishtinës.

Arbenita Murseli tha se Prishtina ka potenciale të zhvillimit të turizmit, fushë kjo e cila është lënë nën hije, fatkeqësisht.

Mundësitë për zhvillimin e turizmit janë të shumta. Të fillojmë me parkun nacional "Gërmia", që ka resurse të pashtershme e që nuk po shfrytëzohen, p.sh. ndërtimi i teleferikëve, që dikur u përfol se do të ndërtohen, por edhe pas njëzet viteve nuk ka asgjë të re në atë drejtim. Resurs tjetër është edhe liqeni i Badocit, që tash për tash nuk ka asnjë investim. Në këtë zonë duhet të investohet në infrastrukturë, së pari në ndriçim, pastaj edhe në rrugë, duhet të ndërtohet një rrugë që qasja të jetë sa më e lehtë, sidomos përmes lagjes së Matiçanit dhe Hajvalisë.

Po ashtu, kemi edhe rajonin që me bukuritë natyrore të mahnitë në të gjitha stinët e vitit, Gollaku që është lënë nën hije, në vend që të jetë një sinonim i turizmit në rajonin e Prishtinës, pra mundësisë së ndërtimit të qendrave të skijimit, teleferikëve, ndërtimi i kampingjeve etj., që të shijohen ato bukuri natyrore.

Egzon Azemi pyeti se pse nuk është duke funksionuar pika për informimin e turistëve, e cila deri vonë ka funksionuar.

Nol Nushi, lidhur me Strategjinë, kishte vërejtje rreth termit komunitetit LGBT, i cili tha se nuk mundemi me thënë kështu, "Prishtina ka kushte për turizëm për komunitetin LGBT", praktikisht po thuhet kështu. Nuk jam për me e hequr këtë term, por duhet me e ndryshuar, edhe ai që e ka hartuar me na treguar se çka ka dashur me thënë, kushdo që është ai.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin.

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, u miratua **Vendimi për miratimin e Strategjisë së zhvillimit të turizmit në Komunën e Prishtinës.**

Pika e shtatë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Busi.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për dhe 1 kundër, u miratua **Vendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Busi.**

Pika e tetë

Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2019.

Osman Billaca tha se të gjitha subjektet politike duhet të përfaqësohen me nga një anëtar në grupin punues, por duhet të ketë edhe respektim në barazinë gjinore. Për anëtarë të Grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2019, nga subjektet politike u dhanë këto propozime:

Faqe 13 nga 18

Halim Halimi, nga LDK-ja propozoi Jeta Rafunën;
Leonora Shabani - Bajraktari, nga LVV-ja propozoi Egzon Azemin;
Vala Peshku, nga PSD-ja propozoi Bashkim Behën;
Migjen Shala, nga PDK-ja propozoi Leutrim Retkocerin;
Fadil Gashi, nga AAK propozoi Valbona Ajetin;
Nga LB u propozua Bukurie Canolli dhe nga Nisma u propozua Baton Dushi;
Përfaqësues nga Zyra ligjore u propozua Florina Rrahmani, përfaqësues nga ekzekutivi u propozua Osman Bllaca dhe përfaqësues nga Sektori për shërbime të Kuvendit, u propozua Luljeta Selimi.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për, 1 kundër, u miratua Vendimi për formimin e Grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2019.

**Pika e nëntë
Pyetje dhe përgjigje.**

Agim Gashi, për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm:

Udhëzimi administrativ 01/2018, neni 38, pika 3 thotë: "Drejtoritë sektoriale të Komunës çdo vit hartojnë raportin monitorues të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të deklaruara në Planet rregulluese të hollësishme, dhe ato raporte ia dorëzojnë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim."

- Meqenëse ky Udhëzim është miratuar bukur herët në këtë vit, pse sivjet nuk ka pasur një raport të tillë në Kuvend, se tash jemi në seancën e fundit?

Vjosa Hamiti - Krasniqi, për Kryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Kur do të bëhet zbulimi i sheshit për Vitin e Ri?
- Për shtëpizat të cilët kanë aplikuar banorët për projektin "Verë në dimër", aplikimi ka përfunduar të premtën, por kur do të jepet përgjigja për qytetarë?
- Banorët e fshatit Shashkovc nga muaji gusht nuk kanë ujë. Ata janë drejtuar tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, por ajo i është përgjigjur se kjo çështje është në kompetencën e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, ndërsa kur drejtohen tek ju, ata marrin përgjigje se kjo i takon Ujësjiellit.

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se ky investim të cilin e keni potencuar, i takon në tërësi KUR "Prishtina", pra ndërtimi i rrjetit të ujësjiellit, mirëmbajtja e tij dhe pompimi janë në kuadër të KUR "Prishtina".

Komuna e Prishtinës, gjegjësisht Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave do të ngritë si problem së bashku me KUR Prishtinën, këtë shqetësim të banorëve të Shashkovcit. Nëse ka mundësi bashkëpunimi, ne jemi të gatshëm me bashkëpunuar me KUR "Prishtina", që ky hall i banorëve të përfundojë.

Naime Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për Kryetarin e Komunës:

- Banorët e rrugës "Ismet Krasniqi" kërkojnë të bëhet ndriçimi i rrugës, sepse fëmijët janë të rrezikuar nga qentë endacakë. Po ashtu edhe banorët afër rrugës "Xhemë Tërnavci", thonë se deri kur do të jemi të anashkaluar nga Kryetari i Komunës sa i përket punësimit?
- Deri kur do të vazhdojë me faturimin e mbeturinave për mërgimtarët, andaj dhe ata pyesin se si do të zgjidhjet kjo çështje.
- Disa qytetarë - mërgimtarë, pagesën shumën prej 1 euro për të hyrë në Stacionin e autobusëve, të cilën e konsiderojnë vjedhje, andaj kërkoj që kjo pagesë të hiqet tërësisht, sepse në asnjë qytet në botë nuk paguhet hyrja në Stacion të autobusëve.

Mirsad Viti, në cilësinë e anëtarit të Komisionit komunal të aksionarëve, kemi marr vendim që kjo platformë, ose kjo pagesë që bëhet prej qytetarëve, ku paguhet 0.10 centë, 0.50 centë dhe 1 euro, për linjat më të gjata, këtë vendim ta shfuqizojmë, që në njëfarë mënyre qytetarët kanë të drejtë që shprehen se kjo është plaçkitje.

Eman Rrahmani, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorinë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Kërkoj që të jepet një shpjegim për një zë buxhetor që është paraqitur në Raportin e tremujorit të tretë, ku paraqitet një shpenzim prej 179 mijë euro për Tregun e qytetit. Cila kompani ka përfituar dhe në bazë të cilës punë që e ka bërë janë përfituar këto mjete, për shkak se si zë buxhetor ai është i paraparë për Tregun e qytetit, pra Tregun e gjelbër, dhe deri sot nuk është bërë asnjë punë? Ndoshta kishte qenë mirë me e shpjeguar, për shkak se unë jam drejtuar edhe në seancën e kaluar, nuk kam marrë përgjigje, jam drejtuar edhe me e-mail, por nuk kam marrë përgjigje, dhe mua më lind dyshimi që këtu është një keqpërdorim dhe dikush ka përfituar nga ky transaksion.
- Kërkoj që, brenda mundësive, rruga "Nebil Duraku" të shtrohet të paktën me zhavorr, për shkak se është e pakalueshme rruga e cila lidhë Qendrën e Panairëve në rrugën Prishtinë – Podujevë.
- Një kërkesë nga shkolla "Zenel Hajdini" për ndriçimin e oborrit të shkollës, për shkak se ajo punon me dy ndërresa, me çka do të lehtësohej qarkullimi për nxënësit të cilët janë në ndërresën e pasdites.
- Kërkoj që në fshatin Bardhosh të bëhet rregullimi i trotuarit të rrugës magjistrale Prishtinë – Podujevë, për lëvizjen sa më të lirë dhe të sigurt të nxënësve për në shkollën fillore "Anton Zako Çajupi".

Egzon Azemi, për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe për drejtorin e Drejtorisë së Administratës:

- Kërkoj një përgjigje nga z. Genc Bashota, drejtor, se cila ka qenë arsyeja e takimit me z. Sami Lushtakun. Këtë lajm e kemi parë në medie dhe për mendimin tim nuk duket diçka e mirë, e që nuk ka pasur deri tash një kundër reagim nga z. Bashota, kur një takim i tillë nuk ka ndodhur në zyrë, por në restorante private.

- Punëtorët e këtij objekti të Komunës kërkojnë që banjat e këtij objekti të kenë kushte sado pak më të mira.

Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, tha se për hir të opinionit do të përgjigjem. Me z. Lushtaku njihem kaherë, para se me hy në politikë. Me pasur diçka që ndërlidhet me Komunën, nuk isha dalë nëpër restorante, d.m.th. publike është ajo, nuk ka nevojë me u fshehur, e njoh, vazhdoj me e njohur, e kam takuar më herët dhe vazhdoj me e takuar edhe në të ardhmen, kështu që ai ishte një takim legjitim dhe shumë privat, arsyet nuk t'i tregoj.

Arbenita Murseli, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Trotuari i rrugës "Dëshmorët e Gollakut", në lagjen Hajvalia, që lidhet me shkollën fillore "Shkëndija", për qarkullim është në gjendje tejet të mjerueshme, ku më të rrezikuarit janë fëmijët kur shkojnë në shkollë.
- Kërkesë tjetër për këtë lagje është edhe ndërtimi i kabinave për stacione të autobusëve.
- Në lagjen "Mati 1", përkatësisht në rrugën "Tasim Elezi", mungon ndriçimi, një lagje e cila është pak minuta larg qendrës, mungesa e ndriçimit është diçka e papranueshme, andaj shpresoj që drejtoria do ta ketë parasysh edhe ta shtrijë ndriçimin edhe në atë zonë.
- Në lagjen "Sofalia", në rrugën "Sabit Mikushnica", e cila vazhdon të jetë në atë gjendje të mjerueshme edhe pas parashtrimit të kësaj kërkesë, drejtoria ka bërë disa intervenime të vogla, ndërkaq rruga vazhdon të jetë në të njëjtën gjendje.
- Rruga "Azem Morana", në lagjen "Taslixhe", edhe përkundër premtimve nga Komuna, rruga ka mbetë e parregulluar. Kur do të fillojnë punimet për rregullimin e kësaj rruge?

Halim Halimi, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Operatorët e transportit privat të linjës 3A, kanë bërë ankesë lidhur me kufizimin e linjës së komunikacionit, të cilën e kanë pasur për destinim të caktuar prej linjës 3 dhe 3 C. Andaj, duke pasur parasysh edhe protestat të cilat i kanë bërë para Komunës edhe kërkesën që e kanë bërë, për këtë kërkojmë një informatë nga ekzekutivi.

Suzan Kika, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Banorët afër rrugëve "Gazmend Zajmi", "Isa Kastrati", "Dëshmorët e Marecit" dhe të Zllatarit, kërkojnë të dinë se kur do të rregullohet çështja e linjave të për transportin publik për këto lokalitete.
- Kërkojmë nga kryetari që të ndërmarrë iniciativën e vendosjes së shtyllave të mbrojtjes nëpër trotuare të rrugës "Isa Kastrati", që vërtet është bërë ferr për këmbësorët deri në pikën ku ndahet rruga për Mat dhe Varrezat e Dëshmorëve.
- Po ashtu, qytetarët e Prishtinës po ballafaqohet me probleme ditore, që duhet dhënë zgjidhje, nuk mund të pritët gjatë sikur që po thirremi në planin e mobilitetit, që qytetarët të durojnë kaosin urban, i cili po ndikon shumë në shëndetin dhe kohën e tyre. Këtë e argumentoj me faktin e ndotjes së ambientit si rezultat i gjendjes aktuale, p.sh. na krijohen tollovi të papara, sepse Komuna nuk cakton pika të pritjes apo nuk

respektohen si nga operatorët, ashtu edhe nga qytetarët, dhe a ka logjikë që autobusi të ndalet sipas tekeve të qytetarëve.

- Ne duhet të marrim masa parandaluese të rrezikut në komunikacion, në veçanti në rrugët "B", "C" dhe në rrugën "Bill Klinton", besoj se e dini të gjithë se këtu përveç se kemi humbje jete të njerëzve, çdo ditë kush e frekuenton këtë rrugë, sheh se të gjithë kategoritë e qytetarëve janë të rrezikuar, në veçanti pleqtë dhe fëmijët.

Kushtrim Sopa, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit, për drejtorinë Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Qytetarët afër rrugës "Bajram Bahtiri", më konkretisht rruga "Sarajeva", shitësit e druve shkaktajnë tollovi të madhe, pluhura, zhurma, andaj një numër i madh i qytetarëve kërkojnë të merren masa ndaj tyre, pasi në legjislaturën e kaluar i është ndarë parcela për këtë aktivitet, që do të thotë është tek Fusha e Pajtimit.
- A do të ndërmerren masa lidhur me këtë çështje?
- A do të bëhet ndonjë zgjidhje alternative për komunikacion në pjesën e propozuara për shesh, te Katedralja, që grupi i ekspertëve e sugjerojnë tunel, apo diçka të tillë?
- A do të modernizohet Tregu i vjetër, apo do të rivendoset diku tjetër, cili është plani i ekzekutivit për këtë çështje?

Egzon Azemi, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Cila ishte kërkesa dhe nevoja për të investuar në rrugën këtu afër Agjencisë Kundërkorrupsion", që është shtruar në asfalt e ka qenë e shtruar në kubze? Meqenëse nuk ka pasur probleme ajo rrugë, siç kanë shumë rrugë të tjera që kubzet janë krejtësisht të dëmtuara, e pikërisht aty është bërë ai renovim, në fakt ky investim.
- Kur do të përfundojë ndërtimi i rrugës "Sheshi i Arbit", për shkak se është një ndër rrugët më problematike në Prishtinë?
- Pse nuk po funksionon numri telefonik i Qendrës së thirrjeve, numri pa pagesë për telefonata të qytetarëve, ku dihet se në mandatin e kaluar gjatë qeverisjes së Shpendit, gjatë qeverisjes si Lëvizje, ka qenë një ndër të arriturat më të mëdha funksionalizimi i Qendrës së thirrjeve, dhe pikërisht përmes asaj qendre janë parandaluar dhe ndaluar shumë ndërtime pa leje, të cilat sot po lulëzojnë.
- Përgjegjësi e kujt është rifunksionalizimi i Qendrës së thirrjeve dhe kur do të rifunksionojë ky numër?

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se ajo rrugë ka një pjerrtësi jashtëzakonisht të madhe dhe ka qenë shumë e dëmtuar, d.m.th. kanë qenë gropat e mëdha dhe ne e kemi parë si të domosdoshëm intervenimin aty. Në atë rrugë është intervenuar para trembëdhjetë vjetëve, pasi që afati i përdorimit të kubzeve është maksimumi pesë vjet. Por nuk është vetëm ajo rrugë, ka edhe shumë rrugë të tjera që ne kemi intervenuar në sanimin e tyre.

Shumica e rrugëve të cilat ju i paraqitni për sanim, rikonstruktiv dhe ndërtim, tash kanë dalë në tenderim, dhe këto mund të shihen në Prishtina Online, pra në fazën e tenderimit është edhe projekti për ndërtimin e rrugës "Sheshi i Arbrit".

Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se sa i përket pyetjeve që bëhen nga anëtarët e Kuvendit, e në veçanti për pyetjet e parashtruara nga znj. Osmani, për pyetjet e bëra ne i kemi dhënë përgjigjet, edhe pse janë gati pyetjet e njëjta në çdo seancë.

Sa i përket ndriçimit të rrugës "Ismet Krasniqi", ai tha se kjo rrugë ka ndriçim.

Për tarifën që kanë të bëjnë me pagesën rreth grumbullimit të mbeturinave, kjo tarifë është e paraparë me rregullore, këtë veç e kam cekur edhe më parë.

Rreth mundësisë së ndriçimit të oborrit të shkollës fillore "Zenel Hajdini", mund ta fillojë këtë iniciativë, me pyetur pse nuk ka ndriçim, ndoshta ka ndonjë defekt.

Për ankesën e operatorit privat të linjës "3A", tha se paraprakisht duhet ditur se

çfarë kontrate ka ai operator dhe deri ku e ka vijën e operimit. Pra, këta operatorë ka një kohë të gjatë që veprojnë pa kontratë.

Rruga "B" është një prej rrugëve që më së miri është me sinjalizim horizontal dhe vertikal.

Sa i përket numrit telefonik të Qendrës së thirrjeve, numri pa pagesë që ka qenë me telefonuar qytetarët, pritet që brenda javës të funksionojë dhe do të jetë pa pagesë.

Gëzim Mehmeti, drejtor, tha se sa i përket pyetjes së parashtruar nga z. Rrahmani, Komuna e Prishtinës e ka një transparencë jashtëzakonisht të mirë sa i përket shpenzimeve, çdo gjë bëhet përmes llogarisë bankare. Për ato pyetjet që po i parashtron ke me marrë përgjigjen, sepse nëse është bërë një pagesë, ajo bëhet përmes bankës, është e pa mundur me u evituar transparenca. Çdo gjë bëhet me transparencë, aty shihet çdo gjë çka është shpenzuar.

Sa i përket rregullimit të trotuarit në rrugën magjistrale Prishtinë- Podujevë, konkretisht në fshatin Bardhosh, kjo zonë është pjesë e pronës së Qeverisë dhe pa pëlqimin e tyre ne nuk mund të investojmë.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta**



Faqe 18 nga 18